



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



ARKIVA DALËSE  
IZLAZNE ARHIVE  
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv./Br. Inv. 01-413101-27772  
Nr. Faqeve/Br. Str./No. Pg. \_\_\_\_\_  
Data/Datum/Date 12.06.2016

Gjakovë, Đakovica - Gjakova

**Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në fushën e profilizuar të të drejtave digjitale**

1. Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i profilizuar në fushën e të drejtave digjitale, me fokus të mbështetjes në iniciativat lokale që rrisin ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi të drejtat digjitale, mbrojtjen e të dhënave personale dhe përdorimin e sigurt të teknologjive digjitale si dhe fuqizimi i të rinjve, qytetarëve dhe institucioneve lokale për të promovuar standarde më të larta të privatësisë dhe llogaridhënies digjitale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në fushën e të drejtave digjitale.
2. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në promovimin e shoqërisë civile lokale aktive, në edukim digjital, edukim dhe pjesëmarrje qytetare, me qëllim të përbushjes së rritjes së ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi të drejtat digjitale, përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve me kushtet si më poshtë:
  - a. Organizata duhet të synoj rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtat digjitale tek qytetarët dhe të rinjtë në komunitet në përgjithësi.
  - b. Organizata duhen të kenë prioritet mbështetjen e iniciativave që promovojnë mbrojtjen e të dhënave personale dhe parandalimin e dhunës digjitale.
  - c. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave rinore, institucioneve lokale dhe shoqërisë civile për çështje digjitale.
  - d. Krijimi dhe promovimi i përmbajtjeve multimediale dhe materialeve edukative për qytetarët dhe komunitetet lokale.
  - e. Ofrimi i rekomandimeve për politika lokale të qëndrueshme në fushën e të drejtave digjitale.
  - f. Organizata duhet të tregojë aftësinë për të promovuar të drejtat digjitale, mbrojtjen e të dhënave personale dhe përdorimin e sigurt të teknologjive digjitale si dhe fuqizimi i të rinjve, qytetarëve dhe institucioneve lokale, për të promovuar standarde më të larta të privatësisë dhe llogaridhënies digjitale.
  - g. Duhet të ketë përvojë në projekte ku integrohen grupet e marginalizuara.

- h. Organizata duhet të marrë parasysh aksesin për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë përkthim në gjuhën e shenjave si dhe Organizata duhet të ketë përvojë në fushat si: edukim digjital, të drejta të njeriut, pjesëmarrje qytetare dhe liderë komunitarë.
3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 10.000 euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është 500 euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është 10.000 euro.
4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve fillon me 12.06.2026 dhe përfundon me datë 02.07.2026.
5. OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partner në më së shumti vetëm me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje.
6. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj. OJQ mund të përfshihet më së shumti në një (1) projekt dhe të përfshihet në zbatimin e vetëm një (1) fushe prioritare.
7. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktiviteteve të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.
8. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.
11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të, duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.
12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / Zyra e Kryetarit (<https://gjakova.rks-gov.net/>)
13. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në Adresa: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës/ Zyra e Kryetarit".
14. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
15. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
16. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në zyrën e Kryetarit të Komunës së Gjakovës deri me datën 24.06.2026